



## **KOSTT: Nënstacioni Fushë Kosovë, Projekti për kablot nëntokësore dhe linjën mbitokësore të transmisionit**

### **Përmbledhje joteknike e projektit**

#### **Pasqyrë e projektit**

KOSTT do të ndërtojë një nënstation të ri që do të jetë i vendosur ngjitur me nënstationin e KEDS 35 kV. Lokacioni përfundimtar i nënstationit nuk është përcaktuar, por janë dy parcela tokësore ngjitur me nënstationin ekzistues të cilat janë me madhësi të përshtatshme për zhvillim.

Përveç nënstationit 110 kV do të jetë një kablo e dyfishtë nëntokësore 110 kV rreth 1.5 km gjatësi me një linjë mbitokësore të transmisionit 110 kV me qark të dyfishtë prej rreth 1.9km në gjatësi.

Kjo linjë e transmisionit do të lidhet me linjën 110 kV nga NS Kosova A deri NS Lipjan. Transformatorët e energjisë 2x40 MVA do të instalohen në NS Fushë Kosovë.

#### **Pse është duke i realizuar këto punime KOSTT-i?**

KOSTT është në përpjekje të përmirësimit të sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike në zonën e Fushë Kosovës. Kjo skemë do të ndihmojë edhe në uljen e ngarkesës në disa nënstacione ekzistuese, për të mundësuar përdorim më të optimizuar të linjës dhe ulje të humbjeve të transmisionit në rrjet të shpërndarjes.

Në përgjithësi, ky program do të ketë një numër përfitimesh të rëndësishme, si:

- Shkarkimi i transformatorëve energjetikë në Nënstationin Prishtina 1 dhe Nënstationin Kosova A;
- Përmirësimi i besueshmërisë dhe cilësisë së furnizimit për konsumatorët në Fushë Kosovë
- Reduktimi i humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes;
- Optimizim i përdorimit të linjës së konvertuar L112 (NS Kosova A - NS Lipjani - NS Ferizaj 2);
- Optimizimi i rrjedhave të ngarkesës në linjat 110 kV, të cilat furnizojnë nënstacionet e Prishtinës, si rrjedhje e shkarkimit të transformatorëve në NS Prishtina 1 dhe NS Kosova A; dhe
- Reduktimi i sasive të mëdha të ngarkesës së padërguar te konsumatorët, si rezultat i eliminimit të fyteve të ngushta në rrjetin e shpërndarjes (vlerësohet të jetë 1000 MWh në vit fillimisht, e cila vlerë pritet të rritet në vitet e mëvonshme).

#### **Çfarë do të përfshijë projekti?**

Projekti do të përfshijë komponentët kryesorë në vijim:

- Ndërtimi i një nënstationi të ri si dhe instalimi transformatorëve të ri dhe pajisjeve të lidhura.



- Ndërtimi i kabllos së re të dyfishtë nëntokësore 110 kV me rreth 1.5 km gjatësi me një linjë mbitokësore të transmisionit 110 kV me qark të dyfishtë prej rreth 1.9km në gjatësi
- Ndërtimi i një lidhjeje me NS Kosova A me linjën e transmisionit NS Lipjani.

Figura 1: Shembull i linjës mbitokësore dhe shtyllës



Përderisa linja mbitokësore dhe kabloja nëntokësore nuk janë finalizuar ende, Figura 2 në vijim paraqet një dizajn të përafërt të rrugës, në pritje të miratimit të dizajnit të hollësisht.

Figura 2: Rruga e përafërt e linjës së transmisionit





Pritet që projekti të mos kërkojë 'Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis' meqë është Shtojcë 2 e projektit, siç përcaktohet me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe nuk pritet të ketë ndikim të konsiderueshëm mjedisor.

Plani për menaxhimin mjedisor dhe të sigurisë për projektin do të sigurojë që të gjitha rreziqet e mundshme do të menaxhohet në mënyrë efektive.

### **Si mund të ketë ndikim në mua ky projekt?**

Në shumicën e rasteve, ndikimet do të jenë minimale dhe vetëm të përkohshme dhe të menaxhuara përmes planit të menaxhimit mjedisor dhe të sigurisë së projektit. Mënyrat që projekti pritet të ketë ndikim tek ju janë:

- Pengim i qasjes në prona të banimit apo lokale afariste;
- Bezdisje përmes zhurmës, dridhjes, pluhurit ose çështjeve rreth qasjes;
- Dëmtimi i rrugëve, vegjetacionit, rrethojave, mureve apo pronave;
- Toka shtesë e nevojshme gjatë aktiviteteve të ndërtimit për ruajtjen e materialeve dhe pajisjeve;
- Blerja e tokës për nënstacionin, kabllot nëntokësore ose linjat mbitokësore të transmisionit.

KOSTT do të menaxhojë punimet ndërtimore/hapjen e kanaleve për të siguruar se minimizohet pengesa dhe qasja në bizneset, në veçanti përmes:

- Rregullimit të operacioneve të hapjes së kanaleve në sekuenca për të siguruar në veçanti që kufizimi i qasjes shmanget sa më shumë dhe, për aq sa është e mundur, për një periudhë sa më të shkurtër.
- Përdorimit të metodave të qasjes alternative gjatë ndërtimit, si qasje e përkohshme duke përdorur ura për këmbësorë.

Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pagesat për të drejta dhe qasje në tokë gjatë ndërtimit dhe operacioneve do të negociohet me pronarët e tokave, KOSTT-in dhe Ministrinë e Financave, në përputhje me Ligjin për shpronësimet në Republikën e Kosovës, para fillimit të ndërtimit.

Aty ku ka bezdisje apo pengesa për bizneset dhe banorët, mund të plotësohet formulari i ankesave i përfshirë në kuadër të planit të angazhimit të palëve të interesit në faqen e internetit të KOSTT-it dhe të dorëzohet tek personi kontaktues i KOSTT-it, Zana Bajrami Rama.

Gjithashtu, KOSTT do ta ketë në veprim një skemë kompensimi për kompensimin e pronarëve ligjorë të tokave dhe bizneseve për çdo pengesë të përkohshme në biznesin e tyre dhe shqetësim ose dëmtim të tokës/pronës që mund të rezultojë nga aktivitetet tona. Kjo do të ndodhë vetëm nëse arrihet pajtim për prova të qarta të humbjeve.

### **Si të ju kontaktoj nëse kam pyetje?**

KOSTT vazhdimisht do të japë informacione për palët e interesuara përmes faqes së saj të internetit dhe kopjeve të shtypura të dokumenteve, që do të jenë në dispozicion në zyrat e kompanisë, si dhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Plani i KOSTT-it për angazhimin me grupet e interesit është e dokumentuar në Planin e Angazhimit me Palët e Interesit të kompanisë, që është në



dispozicion në faqen e internetit të KOSTT-it ose përmes informatave kontaktuese më poshtë.

KOSTT ka procedurë të formalizuar të ankesave dhe lehtësisht pranon të gjitha vërejtjet dhe ankesat përmes këtij mekanizmi. Ky mekanizëm është diskutuar më në hollësi në Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit për këtë projekt. Ankesat dhe sugjerimet do të përgjigjen brenda 15 ditëve kalendarike (deri në 30 ditë kalendarike për çështje komplekse). Individët që paraqesin vërejtje dhe ankesa kanë të drejtë të kërkojnë që emri i tyre të mbahet i fshehtë. Komentet, pyetjet dhe ankesat mund të bëhet me postë, email ose me gojë nëpërmjet kontaktit në vijim:

Personi kontaktues:

Zana Bajrami Rama

Zyra për Marrëdhënie me Publikun

Rr. Iljaz Kodra

P.n. 10000

Prishtinë

Republika e Kosovës

Tel: + 381 (0) 38 501 601 5

Fax: + 381 (0) 38 500 201

E-mail: [info@kostt.com](mailto:info@kostt.com)

Ueb faqja: <http://www.kostt.com/website/>